



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
UNIVERSITETI I TIRANËS
FAKULTETI I GJUHËVE TË HUAJA
DEPARTAMENTI I GJUHËS SPANJOLLE



PROGRAMI MËSIMOR I LËNDËS
Përkthimi A– C (2)

Ngarkesa: 3 (tre) kredite; 30 orë (30 seminare)

Viti / Semestri : Viti I, semestri II

Lloji i lëndës: Lëndë e detyrueshme

Programi i studimit: Master ‘‘Përkthim Teknik-Letrar dhe Interpretim’’

Kodi i etikës: Kodi i etikës i UT-së (nenet 4, 6, 7, 9)

PËRMBLEDHJE DHE REZULTATET E TË NXËNIT:

Objektivat e përgjithshëm: Studentët do të jenë në gjendje të ndjekin sistematikisht një proces përkthimi. Të identifikojnë referencat kulturore dhe sfidat e tjera të përkthimit, të propozojnë dhe justifikojnë strategjitë e duhura të përkthimit dhe kryejnë përkthimet përkatëse në anglisht. Të marrin pjesë aktive në punën e një ekipi përkthyesish. Të zbatojnë kriteret objektive të cilësisë në rishikimin e punës së vet dhe të kolegëve. Të reflektojnë mbi procesin e përkthimit bazuar në përvojën praktike. Të përdorin metagjuhën bazë të përkthimit

Objektivat specifike të lëndës:

Studentët do të jenë në gjendje të:

1. Të reflektojnë për situata të ndryshme përkthimi dhe ti analizojnë ato
2. Të analizojnë tekstet në gjuhët A dhe C për përkthim, duke identifikuar dhe përshkruar sfidat kryesore të përkthimit
3. Të identifikojnë dhe përshkruajnë zhanre tekstesh jo të specializuara në gjuhët e punës
4. Të identifikojnë kontrastet më të shpeshta tekstuale dhe gjuhësore në gjuhët e punës që mund të ndikojnë në procesin e përkthimit
5. Të vlerësojnë dhe diskriminojnë midis burimeve të ndryshme të dokumentacionit

Rezultatet e pritshme:

Gjatë këtij kursi studenti do të përkthejë nga shqipja (A) në spanjisht (C), tekste origjinale, gazetareskë, letrarë, teknikë, nga fusha të ndryshme si feja, drejtësia, etj.

Ky kurs synon të japë studentëve të ciklit të dytë njohuritë bazë mbi terminologjinë e përdorur në fushën politike, juridike dhe ekonomike, si dhe t'i aftësojë në përkthimin e terminologjisë dhe teksteve të ndryshme që studjohen në këto fusha. Lënda synon të nxisë studentët të kryejnë punë kërkimore dhe terminologjike duke punuar me dokumente origjinale, fjalorë terminologjikë, enciklopedi, Internet.